

## Çka janë Gjykatat e grave?

Janë hapsirë për t'u dëgjuar zëri i gruas, për dëshmitë, përvojat, padrejtësitë dhe dhembjet që u janë shkaktuar gjatë luftës dhe në paqë.

Hapësirë për të dëshmuan gratë për dhunën që është ushtruar mbi ato në jetën private dhe publike.

Hapësirë për të dëshmuan rezistencën të organizuar të grave.

## Kur ka filluar procesi i formimit të Gjyqeve femërore-qasja feministe ndaj drejtësisë?

Ka fundi i vitit 2010, 7 anëtare të Këshillit nismëtar (KN) nga pothuajse të gjitha ish republikat e RSFJ-së. Kanë ngritur iniciativë për të oraginzuar gjyqin femëror. Këshilli nismëtar tanë ka 10 organizata në shtetet që dikurë ishin ish republika të RSFJ-së.

Dy vitet e fundit, gratë të veshura në të zeza, ishin bartësë të aktivitetave programore.

## Çfarë kemi bërë deri tanë?

Gjatë dy viteve të kaluara, duke punuar në terren janë organizuar:

- **11** seminare regionale,
- **10** trajnime për prezantime publike,
- **102** prezantime publike në **83** qytete në region,
- **25** filma dokumentarë lidhur me temën,
- **15** mbledhje (punuese, konsultative, mbledhje të këshillit nismëtar, mbledhje me këshillin ndërkombtar këshilldhë-nës),

- **5** mbledhje me grupe femërore për thellim të njohurive lidhur me temën,
- **10** botime (broshura, libra dhe axhenda paqësore) si dhe një numër i madh fletushkash në të gjitha gjuhët e regjionit (shqip, maqedonisht, slovenisht, boshnjake, kroate, serbe).

## Cila periudhë përfshihet në gjyqin femëror?

GjF do të meret me dhunën që është ushtruar në vitet 90-ta,

GjF do të meret me dhunën pas luftërave të viteve 90-ta të shek. XX.

Është konstatuar se ka vazhdimësi të situatës dhe padrejtësive që janë ushtruar gjatë dhe pas luftës.

## Me cilat forma të dhunës do të merret Gjyqi femëror?

Qëndrimet dhe dëshmitë e pjesëmarrseve në proces na jepin njohuri se forma më e shpeshtë e dhunës sipas kuantitetit është:

### I Në bazë etnike:

Dhuna institucionale – Kjo dhunë ka të bëj me hilet dhe padrejtësitë nga policisë që i bëjnë mbi bazë të përkatësisë etnike, dëbimi nga puna për shkak se i përket një minoriteti, ndryshimi i dhunshëm i identitetit etnik, dëbimi nga banesa etj.

Represione në nivel të shoqërisë – Bërrja e padrejtësive të shumta, dëbimi i familjeve që janë nga martesa etnikisht të përziera.

## II Dhunë militariste:

Luftë kundër civilëve – verprime luftarake kërcënimi i pandërprerë, pasiguri për ekzistencën fizike, dëname të dhunshme me uri, terror militarist në kufij.

Represione për shkak të rezistencës përmobilizim të dhunshëm – Ushtrim i dhunës mbi gratë të cilat kanë mbështetur dezertorët e luftës, si dhe dhunë mbi gratë aktiviste që kanë mbështetur dezertimin dhe ndërgjegjen e shëndoshë.

## III Kontinuitet i dhunës bazuar në gjini:

Përdhunimi i cili është krim i luftës, heshtja për përdhunimet, keqërdorimi i përdhunimeve për qëllime nacionaliste, sigmatizimi i grave të cilat kanë dëshmuan për përdhunimet dhe dhunën që është ushtruar mbi ato.

Dhuna e burave mbi gratë, qoftë ajo fizike apo psikike, seksuale, dhuna në bashkësortësi, dhuna në lidhje jashtmartesore dhe dhuna e ushtruar ndaj grave në vende publike si formë e pranuar e sjelljes.

Represion politik ndaj grave mbrojtëse të të drejtave njerëzore.

## IV Dhuna ekonomike:

Privatizimi si krim ndaj grave, heqja ose abrogimi i drejtave në punë si dhe heqja e të drejtave socio-ekonomike etj.

Jeta në varfëri ekonomike në mënyrë të pandërprerë – jetë me frikë të pandërprerë nga varfëria, nga papunësia, frika e dëbimit nga puna si dhe puna pa kompenzim material.

## Dilemat dhe sfidat që janë paraqitur nga proçesi

 a) Çështja e përgjegjësisë – Përvojat nga tereni flasin se në opinion nuk është prezente çështja e përgjegjësisë (morale, politike) dhe kjo për shkak të:

nacionalizmit,  
hedha e përgjegjësisë( mbi të tjerët )çdoher mbi një komb tjetër,  
mohimi dhe minizimi i krimeve të luftës të bëra "në emër të".

Gratë janë të mendimit se këto janë pengesa për paqë dhe drejtësi të mirëfilltë dhe se këtë drejtësi duhet kërkuar, duke e shikuar nga këndi femëror.

 b) Tribunal femëror apo Gjyq femëror? Lidhur me këtë dilemë gratë mendojnë:

Tribunali femëror në mënyrë insitucionale është më i afërt me sistemin juridik.  
Gjyqi femëror mundësom hapësirë më të madhe për të dëshmuar, dhe për të lehtesar shpirtin dhe traumat e grave si dhe ripëtrirjen e mardhënieve.

Gratë janë përcaktuar për model të gjyqit, i cili ka elemente edhe të tribunbalit femëror edhe gjyqit femëror.

 c) Vendi ku do të mbahet gjyqi – Kjo dilemë sipas përgjigjeve më të shpeshta në terren tregon se mund të organizohet në:

Beograd si simbol i përgjegjësisë për krimet e luftës,  
Sarajevë si simbol i vuajtjeve,  
Në shumë qytete si "gjyq lëvizës",  
Në një qytet i cili nuk bart trauma të luftës.

Vendimi përfundimtar për vendin se ku do të mbahet Gjyqi femëror do të sillet në vazhdim të proçesit.



d) Për dëshmitë në Gjyqin femëror përvoja ka treguar se:

Ekziston nevojë e madhe për hapësirë / ambient të sigurt,  
Ekziston frika për përrirje të traumave,  
Ekziston frika nga paraqitja në opinion,  
Ekziston frika për siguri personale dhe për anëtarët e familjes.

Në të gjitha mjediset mbizotëron pasiguri në aspektin politik, etnik, gjinor, socioekonomik, i cili zmadhon pasigurinë dhe ndjeshmërinë e grave.

## Çka kemi bërë ende?

Mbi **200** organizata të shoqërive qytetare që janë kyçur në këto aktivitete,

Në aktivitetet lidhur me GjF kanë marrë pjesë gra nga mëse **100** qytete,

Proçesi i formimit të GjF ka përfshirë mbi **3500** pjesëmarrëse.

Mbi **250** aktiviste / ë drejtpërsëdrejti kanë marrë pjesë për sajimin, realizimin dhe organizimin e këtyre gjyqeve.



Gratë në të zëza  
Jug Bogdanova 18/5, Beograd  
+381 11 26 23 225  
zeneucrn@gmail.com  
www.zeneucrn.com

## GJYKATA E GRAVE

### QASJA FEMINISTE NDAJ DREJTESISE